VENDIM
Nr. 449, datë 26.7.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 584, DATË 8.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 5, të vendimit nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", të ndryshuar, fjalët "... 30 qershor 2023." zëvendësohen me "... 31 dhjetor 2023.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku